


Autoriteti i likuidimit për NSH "Tregu" publikon këtë:

**NJOFTIM PËR ZGJATJEN E AFATIT**

Njoftim për zgjatjen e afatit për aplikim në shpalljen publike të datës 22.01.2024 për 5 pozita për vendin e punës Ofrues i Shërbimeve – për punë administrative të NSH "Tregu" me Nr. të referencës 22012024.

Afati për aplikim zgjatet për shkak se numri i aplikacioneve të pranuar nuk ka qenë i mjaftueshëm. Afati zgjatet edhe për 15 ditë përkatësisht shpallja mbetet e hapur deri me datë 20.02.2024 në ora 16:00.

Nënshkrimi



---

Autoriteti i Likuidimit për NSH "Tregu"

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Në bazë të nenit 3, paragrafi 2 të Rregullores nr. 06/2020 angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve (OSH) në procesin e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH), Autoriteti i Likuidimit shpallë këtë:

## Konkurs per Ofrues të Shërbimeve në procesin e likuidimit

Titulli i pozitës së punës	Ofrues i Shërbimeve – për punë administrative
Kohëzgjatja e emërimit	6 mujor
Paga (bruto) përfshirë kontributet e punëdhënësit	450.00 Euro
Nr. i kërkuar	5
Data e njoftimit	22.01.2024
Afati për aplikim	29.01.2024
Institucioni	Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
Departamenti	Departamenti i Koordinimit Rajonal dhe Operative
Divizioni	Zyra Rajonale Prishtinë, Autoriteti i Likuidimit i PRN104 NSH Tregu
Vendi i punës	<b>NSH “Tregu”</b> -Tregjet e Prishtinës
Nr. i Referencës	22012024

### 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Ofruesi i shërbimeve do të punoj në Administratë.
- Ofruesi i shërbimeve do të punoj në pozitën Zyrtar/e Administrative dhe asiston në të gjitha punët që ndërlidhen në çështjet për NSH Tregun.
- Ofruesi i Shërbimeve angazhohet për ruajtjen dhe ngritjen e vlerës së pronës shoqërore.
- Ofruesi i shërbimeve i caktuar në këtë pozitë i kryen punët dhe detyrat shtesë sipas kërkesës së mbikëqyresit të drejtpërdrejt.

### • 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Vërtetimin nga Policia e Kosovës se ka/nuk ka dosje penale në sistemin informativ të Policisë së Kosovës;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

### 3. Kërkesat e përgjithshme formale

Arsimimi i kërkuar:

---

- Diplomë universitare në Biznes, Ekonomi, Financa, Kontabilitet, Juridik apo ngjajshme;
- Njohuri të mirë pune me pakon e programeve të Microsoft Office;
- Të jetë i përpiktë dhe të ketë aftësi organizative;

#### **4. Kërkesa specifike**

- Përvoja në punë/aktivitet të ngjashëm si dhe ish punëtorët e kësaj NSh-je me përvojë të ngjashme do të konsiderohet përparësi.

#### **5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim**

- Aplikacioni i punësimit (konsiderohet si CV dhe vlerësohet nga Komisioni);
- Kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës;
- Certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit.
- Certifikatë të lëshuar nga Policia e Kosovës që nuk është nën hetime për kryerjen e ndonjë vepre penale.

#### **6. Mënyra e Aplikimit**

- Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kompletuar më së largu me datë 20.02.2024 në ora 14:00 në emalin [punesimi@pak-ks.org](mailto:punesimi@pak-ks.org).

#### **7. Data e shpalljes së rezultateve të vlerësimit përfundimtar**

- Lista e kandidatëve sipas vlerësimit përfundimtar, do të shpallet më së largu deri më datën 27.02.2024,, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>).

#### **8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët**

- Përmes kontakt telefonit, SMS dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>)
-